

VENDIM
Nr.24, datë 16.2.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KQZ-SË
DHE KKRT-SË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 8.5.2011**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 16.2.2011, me pjesëmarrjen e:
Arben Ristani kryetar
Hysen Osmanaj anëtar
Klement Zguri anëtar
Vera Shtjefni anëtare,
në mbështetje të nenit 21 pika 1 dhe nenit 85 pika 1 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi
Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Të miratojë “Marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit
2011”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ristani

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR MONITORIMIN E FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 8.5.2011

Sot më datë 22.2.2011, midis Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe
Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të quajtura “palë” këtu dhe më poshtë, në bazë dhe për
zbatim të nenit 85 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008, nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi.

Palët në këtë marrëveshje bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është angazhimi i palëve, në përputhje me detyrimet përkatëse
ligjore, për përcaktimin e rregullave, për shfrytëzimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të KKRT-
së, për nevojat e monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, në
funksion të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2011.

Neni 2

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi veprojnë në përputhje me ligjin nr.8410, datë
30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
dhe ligjin nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 3

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit merr përsipër:

- a) Të vendosë në dispozicion të Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) studion e monitorimit me pajisjet teknike për monitorim, si dhe personelin teknik dhe monitorues përkatës.
- b) Të vërë në dispozicion të BMM-së ambiente të mjaftueshme për kryerjen e monitorimit.

Neni 4

KQZ-ja merr përsipër shpenzimet financiare për pagesën e personelit që do të angazhohet për monitorim.

Neni 5

KKRT-ja merr përsipër të bëjë regjistrimin e programeve në mënyrë digjitale për 15 (pesëmbëdhjetë) operatorë televizivë dhe në mënyrë analoge për 2 (dy) operatorë radiofonikë. Për regjistrimin e programeve të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë vendorë, të bëjë regjistrime me sondazhe.

Neni 6

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve, që burojnë nga kjo marrëveshje, palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njihet ligji. Në këtë kuadër, KKRT-ja njihet rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për monitorimin e operatorëve radiotelevizivë, në nivel kombëtar dhe vendor, dhe angazhohet për realizimin e detyrave që burojnë nga kjo marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 7

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë më 22.2.2011

PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË RADIOS
DHE TELEVISIONIT
KRYETARE

Edlira Bushati

PËR KOMISIONIN QENDROR
TË ZGJEDHJEVE
KRYETARI

Arben Ristani